



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

20.02.2024, Prishtinë

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





Në bazë të nenit 23, alinea **1.10** të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "FBK"), e duke iu referuar Ligjit të Punës në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-212) dhe Kodit të Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Rregullore QRK Nr. 04/2015), Bordi i FBK-së në mbledhjen e mbajtur më 20.02.2024 miraton këtë:

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË FBK-SË

NENI 1 - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të FBK-së përcaktohet struktura organizative e brendshme e FBK-së dhe funksionimi i Zyrës Ekzekutive të saj, si organ i brendshëm i FBK-së. Anëtarët e Zyrës Ekzekutive, të punësuar me orar të plotë apo me orar të përgjysmuar, si dhe të punësuar të përkohshëm, kanë për qëllim realizimin e mandatit dhe misionit të FBK-së dhe të detyrave të përcaktuara në bazë të përshkrimit të vendeve të punës në kontratat e punës.
2. Rregullorja për Organizimin e Brendshëm të FBK-së po ashtu përfshin edhe strukturat e tjera brenda FBK-së (të formuara kryesisht nga Bordi i FBK-së), mandati i të cilave ka qëllim mbështetjen dhe realizimin e qëllimeve dhe misionit të Federatës.

NENI 2 - UDHËHEQËSI DHE PËRGJEGJËSI I ZYRËS EKZEKUTIVE

1. Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së udhëheq dhe është përgjegjës për punën e zyrës së FBK-së bazuar në Statutin e FBK-së. Sekretarin e Përgjithshëm e emëron dhe e shkarkon Bordi i FBK-së, pas kalimit nëpër fazën e konkursit. Mandati, detyrat dhe modalitetet e raportimit të Sekretarit të Përgjithshëm përcaktohen me Statutin e FBK-së dhe me kontratën e tij të punës.
2. Kandidatët potencialë për postin e Sekretarit të Përgjithshëm të Federatës së Basketbollit të Kosovës duhet t'i plotësojnë kriteret minimale të përzgjedhjes në vijim:
 - Të ketë së paku 3 vite përvojë në pozita udhëheqëse në institucione sportive;
 - Të ketë njohuri të thukëta për sportin e basketbollit dhe menaxhmentin sportiv;
 - Të jetë personalitet i shquar në sferën e basketbollit;
 - Të njohë shkëlqyeshëm gjuhën shqipe, serbe dhe angleze;
 - Të ketë njohuri të shkëlqyeshme në punën me aplikacionet e MS Office dhe komunikim elektronik;
 - Të jetë i gatshëm për të punuar jashtë orarit të punës dhe fundjavave.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP PARTNERS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





3. Përveç kriterëve të mësipërme të përzgjedhjes, Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës do t'i shqyrtojë me prioritet të gjithë kandidatët që kanë përgatitje profesionale superiore, që njohin gjuhë tjera të huaja dhe dëshmojnë përvojë si lojtarë aktivë në sportin e basketbollit.

NENI 3 - ZYRA EKZEKUTIVE E FBK-SË

1. Zyra Ekzekutive e FBK-së përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm që udhëheq dhe është përgjegjës për zyrën e FBK-së (rreth këtyre përgjegjësive asistohet nga Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm) dhe pjesa tjetër anëtarëve të Zyrës Ekzekutive të FBK-së, që përbëhet nga pozitat e paraqitura më poshtë sipas hierarkisë dhe përshkrimeve të vendeve të punës (shih edhe Organogramin të bashkëngjitur kësaj Rregullore):

- Sekretari i Përgjithshëm;
- Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm dhe Menaxheri i Përfaqësuesve të Kosovës;
- Drejtori Teknik;
- Komesari i Garave;
- Menaxheri i Financave;
- Menaxheri i Eventeve dhe Basketbollit 3x3;
- Menaxheri i Projekteve të FBK-së;
- Menaxheri për Media;
- Këshilltari Ligjor për Sport;
- Koordinator i Përfaqësuesve të Reja;
- Asistenti Ekzekutiv;
- Komesari i Garave për Kategoritë e Reja;
- Zyrtari për Marketing;
- Zyrtari i Financave;
- Staf Teknik.

2. Përshkrimi i vendeve të punës të anëtarëve të Zyrës Ekzekutive bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe miratohet nga Kryetari i FBK-së.

3. Sekretari i Përgjithshëm e përcakton mënyrën dhe formën e raportimit që kërkohet nga anëtarët e Zyrës Ekzekutive.

4. Anëtarët e Zyrës Ekzekutive i raportojnë Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të FBK-së në baza javore dhe ky i fundit organizon mbledhje javore për organizim sa më të mirë të punëve.

5. Sekretari i Përgjithshëm organizon takime mujore me stafin e Zyrës Ekzekutive, ku anëtarët e zyrës i raportojnë për punën e tyre. Sipas nevojës, takime të stafit me Sekretarin

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





e Përgjithshëm mbahen edhe para eventeve apo aktiviteteve vendore apo ndërkombëtare, kjo si qëllim organizimin sa më të mirë. Mbikëqyrës i nivelit të parë i këtyre aktiviteteve është Sekretari i Përgjithshëm.

6. Sekretari i Përgjithshëm raporton tek Kryetari në baza ditore, javore e mujore, derisa tek Bordi i FBK-së raporton në baza mujore e vjetore.

7. Drejtori Teknik, Komesari i Garave, Menaxheri i Përfaqësuesëve, Zyrtari për Integritet, krahas Sekretarit të Përgjithshëm dhe Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm, mund ti raportojnë për raste të veçanta edhe Kryetarit të FBK-së, por vetëm me kërkesën e këtij të fundit.

8. Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së ka të drejtë t'i propozojë bashkëpunëtorë të tjerë (të jashtëm apo të brendshëm) Kryetarit dhe Bordit të FBK-së.

9. Kontratat e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe të tjerëve do të përgatiten në pajtueshmëri me ligjin e punës në Republikën e Kosovës. Këta bashkëpunëtorë për punën e tyre i raportojnë Sekretarit të Përgjithshëm.

10. Bashkëpunëtorët e jashtëm dhe të brendshëm (si p.sh. këshilltarë) nuk mund të kenë benefitet e njëjta sikur anëtarët e Zyrës Ekzekutive. Shuma totale e të ardhurave që marrin do të mbulojë të gjitha shpenzimet, dhe nuk mund të ketë kërkesa shtesë për pagesa të tjera (përfshirë këtu: mëditje, derivate, sigurim shëndetësor, laptop, telefon, mbushje telefoni, shfrytëzimi i taksive, etj.).

NENI 4 - NIVELET PËRKATËSE TË AUTORIZIMIT FINANCIAR

1. Sipas Statutit të FBK-së, përgjegjës për mbarëvajtjen financiare të FBK-së janë Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i Federatës, të cilët gëzojnë nivele të ndryshme të autorizimeve sa u përket realizimit të pagesave për nevoja të Federatës.

2. Kryetari i FBK-së ka autorizim të plotë që të menaxhoj dhe operoj me llogaritë e FBK-së, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar me:

- të drejtën për çdo lloj tërheqje, transfere, deponime, transaksione të të hollave pa kufizim;
- të drejtën të nënshkruajë Marrëveshje për E-Banking (marrjen e PIN kodeve për të njëjtat), dhe Marrëveshje për Debit dhe Kredit Kartelë (dhe të bëjë tërheqjen e Debit dhe Kredit Kartelës dhe PIN kodeve);
- të drejtën të nënshkruaj marrëveshjet për mbylljen e Debit dhe Kredit Kartelës si dhe të aplikojë dhe të nënshkruajë Marrëveshjet për POS;

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





- të jetë në gjendje të nënshkruaj PEP, formularët e BQK-së dhe çdo formë tjetër të nevojshme për përditësimin e informacionit.

3. Sekretari i Përgjithshëm gëzon autorizim që të menaxhoj dhe operoj me llogaritë e FBK-së, duke përfshirë por duke mos u kufizuar me:

- të drejtën për çdo lloj tërheqje, transfere, deponime, transaksione të hollave deri në 50,000EUR;
- të drejtën të nënshkruajë Marrëveshje për E-Banking (marrjen e PIN kodeve për të njëjtat), dhe Marrëveshje për Debit dhe Kredit Kartelë (dhe të bëjë tërheqjen e Debit dhe Kredit Kartelës dhe PIN kodeve);
- të drejtën të nënshkruaj marrëveshjet për mbylljen e Debit dhe Kredit Kartelës si dhe të aplikojë dhe të nënshkruajë Marrëveshjet për POS;
- të jetë në gjendje të nënshkruaj PEP, formularët e BQK-së dhe çdo formë tjetër të nevojshme për përditësimin e informacionit;
- të ketë të drejtën, pas konfirmimit nga Kryetari, të transferojë një pjesë ose të gjitha autorizimet e mësipërme personave të tretë për të pasur qasje në llogari nën lirinë e veprimit të tij dhe nivelin e autoritetin që ai vendos (me anë të një vendimi të miratuar nga Kryetari).

4. Të gjitha pagesat dhe investimet e FBK-së duhet të aprovohen/verifikohen nga të dy nivelet e mbikëqyrjes, Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm.

NENI 5 - EMËRIMI DHE SHKARKIMI I ANËTARËVE TË ZYRËS EKZEKUTIVE

1. Sekretari i Përgjithshëm i propozon Bordit të FBK-së profilin e bashkëpunëtorëve të Zyrës Ekzekutive. Bordi i FBK-së miraton, në bazë të projeksioneve buxhetore dhe nevojave të shfaqura, shpalljen e konkursit publik për plotësimin e pozitave të lira apo të reja në FBK.

2. Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryetari i FBK-së janë përgjegjës për realizimin e procedurave të konkursit dhe emërimin e shkarkimin e punonjësve të Zyrës Ekzekutive të FBK-së. Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Zyrës Ekzekutive të FBK-së do të bëhet në pajtueshmëri me ligjin e punës në Republikën e Kosovës.

3. Sekretari i Përgjithshëm do t'i raportojë Bordit të FBK-së për rezultatin e procedurave të emërimit dhe për çdo shkarkim të mundshëm të anëtarëve të Zyrës Ekzekutive të FBK-së jo më vonë se 3 ditë pune pas përfundimit të tyre.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





NENI 6 - DEPARTAMENTET E ZYRËS EKZEKUTIVE DHE FUNKSIONIMI I TYRE

1. Zyra Ekzekutive e FBK-së ndahet në Departamentet si në vijim:
 - a. **Departamenti i Programeve Zhvillimore të FBK-së**, i udhëhequr nga Drejtori Teknik i FBK-së;
 - b. **Departamenti për Media dhe Marketing i FBK-së**, i udhëhequr nga Menaxheri për Media;
 - c. **Departamenti i Garave të FBK-së**, i cili përfshin Komisionin e Garave, Komesarin e Garave, dhe Komesarin e Garave për Kategoritë e Reja;
 - d. **Departamenti i Financave të FBK-së**, i udhëhequr nga Menaxheri i Financave i FBK-së.
2. Secili departament ka udhëheqësin e tij, të cilët janë përgjegjës për ecurinë e punëve në Departamentin që e udhëheqin, përveç Departamentit të Garave që i raporton Bordit të FBK-së nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të FBK-së.
3. Çdo ndryshim në strukturën dhe përbërjen e Departamenteve propozohet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe miratohet nga Bordi i FBK-së.

NENI 7 - STRUKTURAT E TJERA BRENDA FBK-SË

1. Në bazë të Statutit të FBK-së, Bordi mund të formojë trupa punuese (Këshilla dhe Komisione) të përhershme apo përkohshme, tek të cilat mund t'i delegojë kompetencat e veta.
2. **Trupa të përhershme punuese** të Bordit janë:
 - a. *Këshilli Profesional;*
 - b. *Komisioni për Kalimin dhe Regjistrimin e Lojtarëve;*
 - c. *Komisioni Disiplinor;*
 - d. *Komisioni i Garave, mandati i të cilit zgjatë vetëm një edicion garues;*
 - e. *Komisioni Arbitrar;*
 - f. *Komisionet Këshillëdhënëse.*
3. Bordi i FBK-së po ashtu emëron Personin Kontaktues për Integritet (SPOC) apo **Zyrtarin/en për Integritet**, si individ i/e caktuar si ndërmjetës (e) kryesor (e) me akterë të jashtëm për çështjet që përcaktojnë integritetin në sport.
4. Funkcionimi, mandati, procedurat, dhe autorizimet në lidhje me veprimtarinë e strukturave nga paragrafët e mësipërme përcaktohen me rregulloret përkatëse apo

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





përshkrimet e punës, ndërsa mëditjet për anëtarët e këtyre strukturave përcaktohen në bazë të ANNEX 2 të bashkëngjitur kësaj Rregulloreje.

NENI 8 - PAGAT

1. Sekretari i Përgjithshëm si udhëheqës dhe përgjegjës për zyrën ekzekutive të FBK-së, dhe bazuar në detyrat që i dalin nga Statuti i FBK-së, duhet të jetë anëtar i me pagën më të lartë në Zyrën Ekzekutive të FBK-së. Pagën e Sekretarit të Përgjithshëm e përcakton Bordi i FBK-së, në bazë të propozimit të Kryetarit të FBK-së.
2. Meqë Bordi i FBK-së e emëron dhe e shkarkon Komesarin e Garave, Drejtorin Teknik dhe Menaxherin e Përfaqësuesëve, është Bordi i FBK-së ai që i përcakton vlerat e pagave të tyre me propozim të Kryetarit të FBK-së pas vlerësimit të performancës të bërë nga Sekretari i Përgjithshëm në baza vjetore.
3. Lartësinë e pagës për pjesëtarët tjerë të Zyrës Ekzekutive e propozon Sekretari i Përgjithshëm dhe e miraton Kryetari i FBK-së, në bazë të ndarjeve buxhetore të miratuara nga Bordi i FBK-së.
4. Në bazë të performancës vjetore dhe vlerësimit të punës nga Sekretari i Përgjithshëm, ky i fundit mund t'i propozojë Kryetarit të FBK-së rritje vjetore të pagës të anëtarëve të Zyrës Ekzekutive bazuar në ANNEX 1 të kësaj Rregulloreje.
5. Kryetari i FBK-së, si mbikëqyrës i nivelit të dytë i pjesëtarëve të Zyrës Ekzekutive të FBK-së, miraton apo refuzon ngritjen e propozuar jo më vonë se deri më 31 janar të vitit vijues për çdo vit paraprak, duke marrë parasysh ndarjet buxhetore në dispozicion, dhe njofton Bordin e FBK-së për të gjitha vendimet e marra jo më vonë se 10 ditë pune pas marrjes së vendimeve.
6. Është Kryetari i FBK-së ai që propozon ngritjen e pagës së Sekretarit të Përgjithshëm, dhe është Bordi i FBK-së ai që e miraton apo refuzon ngritjen e propozuar.
7. Sekretari i Përgjithshëm mund të propozojë bonuse (duke përfshirë këtu edhe shumën) për anëtarët e caktuar të Zyrës Ekzekutive pas performancës së shkëlqyeshme për një apo më shumë punë të caktuara, ndërsa është Kryetari i FBK-së ai që i miraton apo jo propozimet e tilla. Kryetari i FBK-së është ai që vendos për bonusin e Sekretarit të Përgjithshëm, në rast se do të ketë një të tillë.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





NENI 9 - MËDITJET/KOMPENSIMET

1. Mëditjet për anëtarët e Bordit, anëtarët e trupave punues/komisioneve, dhe ato për bashkëpunëtorë të tjerë të FBK-së, përcaktohen sipas ANNEX 2 të kësaj Rregullore.

NENI 10 - KONTRATAT E PUNËS

1. Kontratat e Punës të Zyrës Ekzekutive do të përgatiten në pajtueshmëri me Ligjin e Punës në Republikën e Kosovës.

2. Kohëzgjatjen e kontratës së punës të Sekretarit të Përgjithshëm e përcakton Statuti i FBK-së, derisa atë të Komesarit të Garave, Drejtorit Teknik dhe Menaxherit të Përfaqësueseve e përcakton Bordi i FBK-së me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm të FBK-së.

3. Ndërkaq për kohëzgjatjen e kontratës së punës të anëtarëve të tjerë të Zyrës Ekzekutive vendos Sekretari i Përgjithshëm në koordinim me Kryetarin e FBK-së.

4. Sekretari i Përgjithshëm është personi përgjegjës që e përfaqëson FBK-në në nënshkrimin e kontratave të punës me anëtarët e Zyrës Ekzekutive.

NENI 11 - INVESTIMI NË NGRITJE TË KAPACITETEVE NJERËZORE

1. Federata e Basketbollit të Kosovës, në interes të ngritjes profesionale të Zyrës Ekzekutive të saj, ka të drejtë të investojë në anëtarët e stafit të zyrës ekzekutive në programe me interes të veçantë për zhvillimin e dyanshëm, të anëtarit të saj dhe të vetë Federatës.

2. Propozimin për ndjekjen e programeve, kurseve, seminareve e punëtorive nga ana e anëtarëve të Zyrës Ekzekutive e propozon Sekretari i Përgjithshëm dhe e miraton Bordi i FBK-së.

3. Palët, në këtë rast Punëdhënësi dhe i Punësuar (apo Federata dhe i/e angazhuari/a), nënshkruajnë Marrëveshje Angazhimi nëpërmjet të cilës zotohen se të dyja palët do të marrin përsipër obligimet, e që në këtë rast Federata merr përsipër mbështetjen financiare, ndërsa i/e angazhuari/a merr përsipër përfaqësimin sa më dinjitoz të FBK-së.

4. Në këtë Marrëveshje përveç raportimit të rregullt tek Sekretari i Përgjithshëm, dhe përgjigjes pozitive ndaj kërkesave të Federatës, i/e angazhuari/a deri në 1 vit pas përfundimit të programit nuk ka të drejtë të kërkojë rritje të pagës, përveçse nëse organet

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP PARTNERS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





kompetente të FBK-së, në këtë rast Sekretari i Përgjithshëm në koordinim me Kryetarin marrim vendim për ta bërë një gjë të tillë, dhe atë pas vlerësimit të performancës vjetore.

5. Marrëveshja përpilohet dhe nënshkruhet nga i/e angazhuari/a dhe Sekretari i Përgjithshëm, si përfaqësues i FBK-së.

NENI 12 - PUNA VULLNETARE

1. Në përputhje me nenin 14 të Ligjit Nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, FBK mund të angazhojë vullnetarë të rinj për të kryer aktivitete joprofitabile. Puna vullnetare e të rinjve nënkupton një aktivitet rinor ku të rinjtë vullnetarisht e pa detyrim, ofrojnë kohën, punën, njohuritë, dhe aftësitë e tyre në shërbim të FBK-së për të mirën e shoqërisë dhe sportit pa pagesë.

2. Të drejtat dhe obligimet e FBK-së dhe vullnetarit janë ato të parapara me ligjin në fuqi në Kosovë, dhe të specifikuara me Udhëzimin Administrativ Nr.1/2016 për Punën Vullnetare të të Rinjve. Këtu hyn edhe lidhja e marrëveshjes me shkrim për punë vullnetare.

NENI 13 - DOKUMENTACIONI I ZYRËS EKZEKUTIVE

1. Për të gjitha dokumentet, materialet dhe shkresat e ndryshme që hyjnë dhe që dalin nga Zyra Ekzekutive e FBK-së duhet të njoftohet Sekretari i Përgjithshëm, i cili për çdo gjë i raporton më pas Kryetarit dhe Bordit të FBK-së.

2. Nënshkrimi i dokumenteve dhe materialeve të FBK-së, bëhet vetëm nga Kryetari i FBK-së dhe Sekretari i Përgjithshëm, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme kur Sekretari i Përgjithshëm apo Kryetari i FBK-së autorizojnë me shkrim një nga anëtarët e Zyrës Ekzekutive për të nënshkruar në emër të FBK-së.

3. Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryetari i FBK-së duhet të jetë pjesë e të gjitha komunikimeve me FIBA-n, MKRS-në, KOK-un, KON-in, Federatat Nacionale dhe me akterët tjerë me peshë në institucione të ndryshme në Kosovë dhe jashtë saj.

NENI 14 - PUSHIMI VJETOR DHE MJEKËSOR

1. Pushimi ditor, javor, vjetor, dhe mjekësor është i përcaktuar në kontratën e punës të anëtarëve të Zyrës Ekzekutive të FBK-së dhe në bazë të Ligjit të Punës në Republikën e Kosovës.

2. Duke marr parasysh natyrën e punës të anëtarëve të Zyrës Ekzekutive dhe aktiviteteve të shumta që organizohen gjatë verës nga FBK, pushimi vjetor i këtyre anëtarëve

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





përcaktohet nga Sekretari i Përgjithshëm në bashkërendim me vetë anëtarët e Zyrës Ekzekutive.

3. Pushimi në festa zyrtare përcaktohet me Kalendarin e Festave Zyrtare në Republikën e Kosovës.

4. Anëtarët e Zyrës Ekzekutive mund të kërkojnë edhe pushim pa pagesë, në pajtim me Ligjin e Punës në Republikën e Kosovës, i cili duhet të miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm.

NENI 15 - PUNA JASHTË ORARIT DHE NË DITËT E FUNDJAVËS

1. Duke marr parasysh natyrën dhe intensitetin e punës me organizimin e aktiviteteve të FBK-së, anëtarët e Zyrës Ekzekutive mund të punojnë edhe jashtë orarit apo në ditët e fundjavës, por më pas në koordinim me Sekretarin e Përgjithshëm ju kompensohen këto ditë.

NENI 16 - KODI I MIRËSJELLJES DHE KODI ETIK I FBK-SË

1. Rregullat e brendshme të mirësjelljes përcaktohen sipas Rregullores për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Kontratës së Punës.

2. Anëtarët e Zyrës Ekzekutive dhe të strukturave të tjera brenda FBK-së duhet të respektojnë edhe Kodin Etik të FBK-së, dhe rrjedhimisht kuptojnë se janë përgjegjës për çfarëdo shkeljeje etike të Kodit (e njëkohësisht pranojnë mundësinë e sanksionimit në bazë të Kodit Etik).

NENI 17 - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

1. Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së si udhëheqës dhe përgjegjës i zyrës ekzekutive të FBK-së për nevoja të zyrës dhe funksionimit sa më të mirë të zyrës ekzekutive të FBK-së ka të drejtë të hartojë rregulla të brendshme që janë në pajtueshmëri me këtë Rregullore dhe Statutin e FBK-së.

2. ANNEX 1 dhe ANNEX 2 të bashkangjitur kësaj Rregulloreje shërbejnë vetëm për konsumim të brendshëm.

3. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj nga Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Miratuar në Prishtinë, më 20.02.2024.

Arben **FETAHU**

Kryetar

Federata e Basketbollit të Kosovës



Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:



ORGANOGRAMI I ZYRËS EKZEKUTIVE TË FBK-SË

DEPARTAMENTET E FBK-SË

DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE ZHVILLIMORE

Udhëheqës: Drejtori Teknik

DEPARTAMENTI I FINANCAVE

Udhëheqës: Menaxheri i Financave

DEPARTAMENTI I GARAVE

DEPARTAMENTI PËR MEDIA DHE MARKETING

Udhëheqës: Menaxheri për Media

